

NJOFTIM PËR APLIKIM

PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE (INSTAT)

Bazuar në pikat 2, 3 e 5, të nenit 16, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, si dhe në vendimin nr. 669, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave, të kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për për zgjedhjen e kandidaturave për t’u emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave””, Këshilli i Ministrave shpall thirrjen për të aplikuar për pozicionin e drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave (INSTAT).

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it kujdeset për të siguruar pavarësinë profesionale të institucioneve brenda sistemit kombëtar statistikor dhe drejton strategjinë e zhvillimit të tij. Ai drejton veprimtarinë koordinuese të aktiviteteve statistikore të prodhuesve brenda sistemit kombëtar statistikor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, pas një procedure të hapur dhe publike për zgjedhëse.

• Aplikanti duhet të plotësojë këto kriterë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ç) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga institucionet e administratës publike;
- d) të ketë gradën shkencore “Doktor” në shkencat ekonomike ose ekzakte;
- dh) të ketë përvojë pune për një periudhë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
- e) të zotërojë gjuhën angleze.

- Dokumentet që duhet të dorëzohen janë:
 - Kërkesë për aplikim;
 - Kopje të letërnjoftimit;
 - *Curriculum Vitae* në gjuhën shqipe;
 - Dokumente të diplomimit;
 - Dokumente që provojnë vjetërsinë në profesion dhe marrjen e gradës shkencore “Doktor” në shkencat ekonomike ose ekzakte;
 - Certifikata e dokumente që provojnë përvojë pune dhe kualifikime në fushën e prodhimit dhe/ose të përdorimit të statistikave;
 - Dokument që provon zotërimin e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera të huaja (nëse ka);
 - Kopje të prezantimeve të punimeve në konferenca/simpoziume shkencore;
 - Formular të vetëdeklarimit (të plotësuar e të firmosur), në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;
 - Formular të aplikimit (të plotësuar e të firmosur) për informim, për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta, në zbatim të ligjit nr.45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
 - Vetëdeklarim se nuk është larguar nga institucionet e administratës publike me masë disiplinore.

(Deklarimi i remë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme e konkurrimit dhe përgjegjësi penale, sipas legjislacionit në fuqi).

- Afati i dorëzimit të aplikimit, deri më 29 gusht 2025.
- Adresa: Kryeministria
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, Tiranë, Shqipëri
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

- Aplikantët njoftohen individualisht dhe nëpërmjet Web-faqes zyrtare të Kryeministrit për verifikimin e plotësisht të kriterëve të kërkuara, procesin e ankimimit, si dhe për informacione të tjera të nevojshme.
- Aplikantët që plotësojnë kriteret i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit dhe një interviste të strukturuar me gojë.
- Data e shpalljes së listës së kandidatëve, që do të kualifikohen për fazën e intervistës: brenda **datës 22 shtator 2025**.
- Data dhe vendi i zhvillimit të intervistës: brenda datës **30 shtator 2025**, Kryeministria.
- Fushat e njohurive, për të cilat do të intervistohen kandidatët, janë:
 - i. njohuri në fushën e statistikave, përmbajtjen e programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare;
 - ii. njohuri për Kushtetutën, Kodin e Procedurave Administrative dhe për legjislacionin e funksionimit të administratës publike;
 - iii. njohuri për legjislacionin mbi të cilin mbështetet funksionimi i sistemit kombëtar statistikor.
- Kandidatët i paraqesin komisionit të posaçëm të vlerësimit të kandidaturave, në ditën e intervistës së strukturuar me gojë (data e së cilës njoftohet individualisht për secilin), një prezantim të shkurtër në format Power Point lidhur me:
 - filozofinë drejtuese;
 - strategjitë e risitë që mund të sjellë gjatë kryerjes së funksionit drejtues.

Inkurajojmë të gjithë të interesuarit për aplikim.